



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAVAJË
KRYETARI**

Nr. 359/ Prot.

Kavajë, më 13. 07.2026

URDHËR
Nr. 306, datë 13 / 07 /2026

**“PËR
ZHVILLIMIN E PROCEDURËS PËR PËRZGJEDHJEN E ORGANIZATËS
JOFITIMPRURËSE PËR OFRIMIN E SHËRBITIT SHOQËROR NË PROJEKTIN E
BASHKISË KAVAJË ME FONDIN SOCIAL SHTETËROR 2026”**

Bazuar në ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”; ligjin nr. Nr.8788, datë 7.5.2001 “Për organizatat jofitimprurëse”; Ligjin Nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” (i ndryshuar); Ligj Nr. 121/2016 “Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror Në Republikën e Shqipërisë” Ligj Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”; Ligji Nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”; Ligji 57/2019 “Për Asistencën Sociale Në RSH”; Ligj Nr.9936, Datë 26.6.2008 Për Menaxhimin E Sistemit Buxhetor Në Republikën E Shqipërisë, i Ndryshuar; Vendim Nr. 285, Datë 19.5.2021 Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik; Vendim Nr. 110, Datë 1.12.2022 Autorizim i Ndihmës Shtetërore “Për Ndërmarrjet Sociale”; Vendim Nr. 150, Datë 20.3.2019 Për Metodologjinë e Llogaritjes së Fondeve për Financimin e Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror; Vendim Nr. 252, Datë 20.4.2023 Për Miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore 2023–2030, Të Planit të saj të Veprimit 2023–2025 e të Pasaportës së Indikatorëve; Udhëzues Fondi Social 2023 Thirrje për Propozime për Njësitë e Qeverisjes Vendore Fondi Social për Shërbime të Kujdesit Shoqëror; Strategjia Kombëtare për Mbrojtjen Sociale; VKM nr 768 datë 12.12.2021 “Për Shërbimet Sociale”; Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 709, datë 24.10.2012 “Për procedurat e financimit të projekteve dhe veprimtarive artistike e kulturore”; si dhe VKM nr. 1173, datë 06.11.2009 “Për përcaktimin e rregullave për organizimin e ngjarjeve kulturore, artistike dhe sociale, nga organet e qeverisjes qendrore dhe institucionet e tjera publike, të pavarura”;

URDHËROJ

1. Nisjen e procedurave të përzgjedhjes së OJF-së për ofrimin e shërbimit shoqëror në Qendrën Sociale Multifunkionale TOK, në bashkinë Kavajë;
2. Vendndodhja e Qendrës është në ambientet e ish-shkollës profesionale "26 Marsi", në lagjen nr 1(një) të qytetit të Kavajës;

3. Qendra Sociale Multifunkzionale TOK është ngritur në bashkëpunim me UNICEF dhe WorldVision Albania, në kuadër të programit EU4SocialCare, financuar nga BE;
4. Fondi limit është 8.000.000 lekë;
5. Zërat që do përdoren janë “Shërbime të përkujdesit në nivel qarku dhe bashkie” dhe “Shtesë fondi për shërbimin Social”, në programin 10430 “Kujdesi Social”, artikulli 606 Ministria e linjës, grupi 13;
6. Procedura duhet shpallet me thirrje të hapur publike, sipas legjislacionit të sipërcituar dhe do të qëndrojë e hapur për 10 (dhjetë) ditë kalendarike në uebin e bashkisë;
7. Format i aplikimit që do përdoret në paketën e thirrjes duhet të optimizohet me formatin e Fondit Social Shtetëror, mbi të cilën Bashkia Kavajë ka fituar projektin.
8. Ngarkohet Drejtoria e Shërbimit Social për ndjekjen e këtij urdhëri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Fisnik Qosja

